

Lorena Çabej- Ndhmësmagjistrate

Lorena Çabej u lind në Gjirokastrë më 9 prill 1991. Në vitin 2012 ka përfunduar studimet në nivelin Bachelor në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, diplomuar me medalje ari. Në vitin 2014 ka përfunduar studimet master, në programin e studimit “Master shkencor - e drejtë civile” në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, diplomuar me medalje ari.

Në vitet 2014-2015 ka punuar në departamentin ligjor të KPMG Albania. Që prej vitit 2015 është angazhuar si pedagoge e jashtme në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë në lëndën e së drejtës civile. Ka përfunduar studimet në Shkollën e Avokatisë në vitin akademik 2014-2015.

Gjatë viteve 2015-2018 ka kryer studimet në Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë. Në vitin 2019 është emëruar gjyqtare me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe është caktuar në pozicionin e gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Me vendimin nr. 433, datë 14.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi komandimin e gjyqtares Lorena Çabej në pozicionin e ndihmësmagjistratit pranë Gjykatës së Lartë.